



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Faqe | 2

Nr. 3532 /₁₀ prot.

Tiranë, më 21. 11. 2023

VENDIM

Nr. 107 datë 21.11.2023

PËR

**MIRATIMIN PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE”, MIRATUAR ME VENDIMIN
NR. 99, DATË 07.06.2017 TË AMA-S**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

VENDOSI:

1. Miratimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin Nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i AMA-s nr. 99, datë 07.06.2017 “Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive”, të amendohet sipas ndryshimeve dhe shtesave të bëra.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Armela

KRASNIQI

Zëvendëskryetar:

Desada

METAJ

Anëtarë:

Aurela

BICJA

Besian

ZOGAJ (kundër)

Gjergji

HAMITI

Jetmir

HALILAJ

Joana

ALLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

DREJTORIA LIGJORE

(Miratuar me Vendimin Nr.107, datë 21.11.2023)

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE”’, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 99, DATË 07.06.2017, TË AMA-S

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “ë”, nenit 54, pika 5 dhe nenit 64 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimin nr. 99, datë 07.06.2017, të AMA-s “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 16 të rregullores bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 16

Detyrime të subjekteve të autorizuar

1. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, është i detyruar të japë të dhëna/informacionin e duhur pranë AMA-s, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *Subjekti që pajiset me autorizim nga AMA për shërbimin OTT, është i detyruar të deklarojë çdo gjashtë muaj, të dhënat mbi numrin aktual të abonentëve dhe tarifën mujore/vjetore të aplikuar për paketat e ofruara.*
2. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi për ofrimin e njërit apo më shumë shërbimeve të parashikuara në këtë rregullore, është i detyruar që:
 - a. Të garantojë ruajtjen e ambienteve ku ndodhen pajisjet transmetuese audio/audiovizive për të ndaluar përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
 - b. Të garantojë ofrimin e shërbimit për përdoruesit pa ndërprerje 24/7 (sipas grafikut kohor të përcaktuar në rregulloren 101 “ *Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv’, e ndryshuar*) dhe me cilësi në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në kushtet e autorizimit.
 - c. Të garantojë prezencën e të paktën një punonjësi ose të një personi të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/ambientin ku janë të

vendosura pajisjet audiovizivedhe në çdo ambient ku emetohet sinjali i transmetimit audio dhe/ose audioviziv, si dhe të lejojë inspektimin e tyre nga inspektorët e AMA-s, në bazë të rregullores përkatëse të AMA-s “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”.

- d. Të përdorë në marrëdhënie me të tretët emrin tregtar si OSHMA, në përputhje me autorizimin e lëshuar nga AMA.
- e. Të paraqesë kanal in formativ që përdor subjekti OSHMA si kanal in e parë në renditjen e programacionit, ku të jenë të paraqitura logoja e subjektit, data dhe ora e transmetimit. Në këtë faqe duhet të jenë të paraqitura të dhënat e kontaktit dhe nuk lejohet asnjë transmetim tjetër audio/audioviziv brenda kanalit.

3. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, është i detyruar:

- a. të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë, të respektojë kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kushtet e autorizimit, të përcaktuara nga AMA.
- b. të nxisë vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit, të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

4. Subjekti që pajiset me autorizim ose i rinovohet autorizimi nga AMA, duhet të njoftojë paraprakisht AMA-n për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura për marrjen e autorizimit, brenda 30 ditëve nga kryerja e tyre. Në mënyrë të veçantë, ndryshimi i ambientit (studios) ku janë të instaluar pajisjet transmetuese audiovizive dhe/ose shtimi i një ambienti të ri duhet të bëhet pas njoftimit paraprak në AMA dhe dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a. adresa e detajuar e ambientit (studios) së ndryshuar, ose të shtuar;
- b. kopje e noterizuar e dokumentit të pronësisë;
- c. dokumenti që vërteton të drejtën e shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.) në rast se ambienti i ri nuk është në pronësi të subjektit.
- d. Projekti teknik i detajuar ku të pasqyrohen ndryshimet përkatëse.

5. Autorizimi është i patjetërsueshëm dhe vlen vetëm për të autorizuarin. Në rast se i autorizuari hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria e autorizuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi kërkohet miratimi i AMA-s. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një autorizimi të ri me të njëjtën përmbajtje. Kur AMA nuk e miraton kalimin, për shkak të parashikuara në ligj, autorizimi është i vlefshëm vetëm për subjektin i cili ka kërkuar cedimin tek një subjekt tjetër, pra tek subjekti i cili disponon autorizimin.

6. Subjekti i pajisur me autorizim nga AMA dhe subjekti të cilit i kalohen të drejtat e autorizimit paraqesin pranë AMA-s, njoftim të përbashkët për ndryshimet e kryera si dhe kërkesën për miratimin e kalimit të të drejtave të autorizimit, shoqëruar me kontratën noteriale të shitjes/dhurimit dhe ekstraktet historike për të dhënat e subjekteve tregtare palë të kontratës së shitjes/dhurimit.

